


# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

## Dhjetor 2020

**Tiranë, më 25 Janar 2021:** Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2020 është 2.657.818, duke rënë me 58,5 %, në krahasim me vitin 2019. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga Shqipëria në vitin 2020, është 2.906.828 duke rënë 50,9 %, krahasuar me vitin e më parshëm (tab1).


Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, 2019 - 2020



Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar, në muajin Dhjetor 2020, është 442.966 dhe krahasuar me Dhjetor 2019, ky tregues rezulton me rënie 50,7 %. Në Dhjetor 2020, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 180.815, krahasuar me Dhjetor 2019, ky numër ka rënë me 37,4 %.

Gjatë vitit 2020, Kosova ka rënien më të ulët të hyrjeve të shtetasve në Shqipëri me 38,6 %, ndërsa rënien më të madhe e ka pasur Spanja me 90,3 %, krahasuar me vitin 2019 (tab.2).

Fig. 2 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Dhjetor 2020



Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Dhjetor 2020 janë 215.698. Krahasuar me Dhjetor 2019, ky numër ka rënë 55,5 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Dhjetor 2020, janë 155.973. Krahasuar me Dhjetor 2019, ky numër ka rënë 47,9 %.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj, Dhjetor 2020

Periudha	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Dhjetor 2019	Janar-Dhjetor 2020	Ndryshimi vjetor (%)
<b>Hyrje Gjithsej</b>	<b>897.696</b>	<b>442.966</b>	<b>-50,7</b>	<b>12.103.767</b>	<b>5.419.417</b>	<b>-55,2</b>
Shqiptarë	608.988	262.151	-57,0	5.697.729	2.761.599	-51,5
Të Huaj	288.708	180.815	-37,4	6.406.038	2.657.818	-58,5
<b>Dalje Gjithsej</b>	<b>784.404</b>	<b>371.671</b>	<b>-52,6</b>	<b>12.181.435</b>	<b>5.543.892</b>	<b>-54,5</b>
Shqiptarë	485.230	215.698	-55,5	5.921.750	2.906.828	-50,9
Të Huaj	299.174	155.973	-47,9	6.259.685	2.637.064	-57,9

**Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj, Dhjetor 2020**

Shtetet	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Dhjetor 2019	Janar-Dhjetor 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	75.211	85.648	13,9	2.246.540	1.379.360	-38,6
Maqedoni	40.655	31.826	-21,7	753.533	370.135	-50,9
Greqi	56.969	5.714	-90,0	596.884	203.445	-65,9
Itali	31.789	9.648	-69,6	467.745	123.489	-73,6
Angli	8.635	3.849	-55,4	133.175	53.402	-59,9
Mali i zi	27.836	18.746	-32,7	366.817	174.233	-52,5
Poloni	636	317	-50,2	132.403	24.404	-81,6
SHBA	4.414	2.07	-53,1	119.179	24.57	-79,4
Spanjë	583	188	-67,8	28.75	2.801	-90,3
Gjermani	4.128	3.252	-21,2	165.703	39.461	-76,2
Zvicër	2.750	3.466	26,0	64.87	18.389	-71,7
Të tjera	35.102	16.091	-54,2	1.330.439	244.129	-81,7
<b>Gjithsej/Total</b>	<b>288.708</b>	<b>180.815</b>	<b>-37,4</b>	<b>6.406.038</b>	<b>2.657.818</b>	<b>-58,5</b>

**Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit, Dhjetor 2020**

Periudha	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Dhjetor 2019	Janar-Dhjetor 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	288.708	180.815	-37,4	6.406.038	2.657.818	-58,5
I. Personale	279.517	170.162	-39,1	6.304.845	2.542.494	-59,7
1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor, etj.	262.483	155.022	-40,9	6.095.547	2.458.883	-59,7
2. Qëllime fetare	38	28	-26,3	794	326	-58,9
3. Udhëtarë transit	16.996	15.112	-11,1	208.504	83.285	-60,1
II. Biznes dhe profesionale	9.191	10.653	15,9	101.193	115.324	14,0

**Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit, Dhjetor 2020**

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Dhjetor 2019	144.408	57.809	695.479	142.337	25.728	616.339
Dhjetor 2020	50.816	28.666	363.484	33.749	10.566	327.356
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-64,8</b>	<b>-50,4</b>	<b>-47,7</b>	<b>-76,3</b>	<b>-58,9</b>	<b>-46,9</b>
Janar-Dhjetor 2019	1.659.594	842.904	9.601.269	1.426.985	781.025	8.401.662
Janar-Dhjetor 2020	657.467	233.538	4.528.412	649.044	223.890	4.670.958
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-60,4</b>	<b>-72,3</b>	<b>-52,8</b>	<b>-54,5</b>	<b>-71,3</b>	<b>-44,4</b>

# Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

## Përkufizime

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet:** Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

**Vizitor:** Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

*Qëllime personale* të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor etj.;
2. Qëllime fetare;
3. Udhëtarë tranzit.

*Kategoria e biznesit* që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu:

<http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

**Diferencat statistikore misdis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:**

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.